

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Projektligji që "blen" Kushtetuesen/ PD bën kërkesë për seancë dëgjimore publike
ADRESA	https://www.cna.al/politike/projektligji-qe-blen-kushtetuesen-pd-ben-kerkese-per-seance-degjimore-p-i474195
BURIMI	cna.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 08:44:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 08:27:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	69f723ab4eb139d83cd486d3324f151746a60da051a430df3403c3400b6cf903
TEKSTI	b3f1ab0e30bab0835be008cdc399d59a1e273113f0eb3de035fa57a7b8ca1cf0
PAMJA	cc3ed1c96f3ac2c972b4cdbe57e263e5332f8453ee4630eefba0b6c6834bdf43

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d5fc3740d65b66685edac00057f64844967448a01aeebab71f818d0fa9bd5770
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	908b1c27d6fb4398f588aae15509a84ac3468307df4d4ded5fae648af40858f1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/d5fc3740d65b66685edac00057f64844967448a01aeebab71f818d0fa9bd5770>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

10:27 Politikë

Partia Demokratike ka depozituar një kërkesë në Komisionin...

Projektligji që "blen" Kushtetuesen/ PD bën kërkesë për seancë dëgjimore publike



15 Shtator 2026, 10:27, Politikë CNA



Partia Demokratike ka depozituar një kërkesë në Komisionin e të Drejtave të Njeriut për zhvillimin e një seance dëgjimore publike mbi projektligjin e propozuar nga dy deputetët socialistë, Aulona Bylykbashi dhe Admir Kadeli.

Bëhet fjalë për projektligjin e propozuar "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 'Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë', të ndryshuar".

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ✓

Nr. 3997 Prot.

Tiranë, më 15.09.2026

Lënda: Kërkesë për zhvillimin e një seancë dëgjimore publike mbi projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Drejtuar: Znj. Jorida TABAKU
Kryetare e Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik.

E Nderuar Znj. Kryetare,

Pranë Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, është duke u shqyrtuar projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Në thelb, ky projektligj ka për qëllim për të “përmbyshur detyrimin kushtetues të vendosur nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 15, datë 17.02.2026”, duke sanksionuar “norma të cilat garantojnë përlllogaritjen e pagës së magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë), në përputhje me vendimin e Gjykatës.” (shih fq. 1 të relacionit shoqërues).

Lidhur me procedurën parlamentare të ndjekur për miratimin e ndryshimeve ligjore tashmë të shfuqizuara (Ligji Nr. 33/2023), Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “Gjatë procedurës parlamentare nuk rezultoi të jetë dëgjuar as mendimi i gjyqtarëve/prokurorëve në lidhje me ndryshimet e reja ligjore. Gjatë seancës plenare përfaqësuesit e kërkuarit dhe subjektit të interesuar, KLGJ-së, u shprehën se disa grupe gjyqtarësh, individualisht ose nëpërmjet gjykatave kanë shprehur mendimet e tyre për ndryshimet ligjore, por se nuk kanë qenë pjesë e grupit të punës dhe as të thirrur nga komisionet përkatëse. Edhe pse KLGJ-ja, siç është shprehur në parashtrimet e saj drejtuar Gjykatës, ka shprehur dakordësinë për projektligjin, ajo ka evidentuar disa çështje që duhej të gjenin reflektim, për të cilat në aktet parlamentare nuk jepet shpjegim përse nuk janë pranuar. Ndërsa në mbledhjet e komisioneve (atij të Çështjeve Ligjore dhe të Ekonomisë) përveç përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, që kanë mbrojtur propozimin e tyre sipas projektligjit, nuk ka pasur përfaqësues të organeve të drejtësisë ose të vetë grupeve të interesit. Prandaj, në vlerësimin e Gjykatës, procesi i konsultimit, nga

pikëpamja kushtetuese, nuk ka rezultuar të ketë qenë efektiv.” (shih vendimin Nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, §98).

Ndërsa, lidhur me procedurën parlamentare që duhet të ndiqet në vijim, Gjykata Kushtetuese është shprehur se: “Parimi i shtetit të së drejtës dhe i sigurisë juridike kërkon, në aspektin formal, që elementet dhe parimet që lidhen me sistemin e pagave të magjistratëve të përcaktohen me ligj të miratuar nga Kuvendi, **përmes një procedure transparente**, kurse në aspektin substancial, që parashikimet ligjore të jenë objektive, të parashikueshme, të qëndrueshme dhe transparente, për të përjashtuar ndërhyrje arbitrare të pushtetit ligjvënës ose ekzekutiv gjatë zbatimit të tyre. **Kjo nënkupton edhe që gjatë shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve ligjore që prekin drejtpërdrejt garancitë kushtetuese të magjistratëve, ku përfshihen pagat e tyre, procesi ligjvënës duhet të përfshijë një analizë tërësore dhe të detajuar të qëllimit të synuar dhe pasojave të pritshme, sikundër duhet të sigurojë edhe pjesëmarrjen aktive të vet gjyqtarëve/magjistratëve ose grupimeve që i përfaqësojnë ata. Ky konsultim duhet të jetë, mbi të gjitha, edhe efektiv.”** (shih vendimin Nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, §76).

Duke qenë se projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ka të bëjë pikërisht me garancitë kushtetuese të magjistratëve, ku përfshihen pagat e tyre, në zbatim të konkluzioneve dhe orientimeve të vendimit Nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet komisioneve parlamentare, duhet të sigurojë edhe pjesëmarrjen aktive të vet gjyqtarëve/magjistratëve ose grupimeve që i përfaqësojnë atë, nëpërmjet një konsultimi efektiv.

Në këtë kuptim, Kuvendit të Shqipërisë i lind detyra që gjatë procesit legjislativ të organizojë seanca dëgjimore publike me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, përkatësisht Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorëve, institucionet e drejtësisë, përkatësisht Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme, Prokurorin e Përgjithshëm, Kryetarin e Gjykatës së Lartë, dhe shoqatat e magjistratëve, përkatësisht Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Shqipërisë dhe Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë. Ky detyrim vlen për të gjitha organet e Kuvendit, përfshirë Komisionet për dhënie mendimi, pra edhe për Komisionin tonë.

Neni 36 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë përcakton se: “1. Komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike me anëtarë të Këshillit të Ministrave, përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të shoqërisë civile, përfaqësues të grupeve të interesit, si dhe grupime të tjera të interesuara. Komisioni është i detyruar të realizojë seancën dëgjimore, sipas përcaktimeve të bëra në këtë nen, në rast se një e treta e të gjithë anëtarëve të komisionit e kërkon atë në mënyrë të motivuar me shkrim. Kur seanca dëgjimore kërkohet nga 1/3 e anëtarëve të komisionit, Komisioni mbledhet brenda 2 ditëve kalendarike nga paraqitja e kërkesës. 1/1. Gjatë procesit legjislativ, komisioni mund të organizojë seanca dëgjimore publike sipas përcaktimeve të bëra në pikën 1 të këtij neni. Komisioni nuk mund të

përgatisë raportin për seancë plenare pa u realizuar seanca dëgjimore. 2. Në përgatitjen e seancës dëgjimore publike, kryetari, në bashkëpunim me zëvendëskryetarët dhe sekretarin e komisionit, u paraqet të fuarve çështjet për të cilat kërkohet informacion.”.

Në këto kushte, ne, deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, në cilësinë e anëtarëve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetat e Informimit Publik, që mbledhet në datën 26

pikat 1 dhe 2, të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, si dhe në përputhje me konkluzionet dhe orientimet e detyrueshme për zbatim të vendimit Nr. 15/2026 të Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 132 të Kushtetutës,

KËRKOJMË:

1. Zhvillimin e një seance dëgjimore publike lidhur me projektligjin *"Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"*, me qëllim marrjen e mendimit të tyre për përmbajtjen e këtij projektligji, me institucionet dhe shoqatat që kanë interes në këtë çështje, si më poshtë:

- (i) Këshillin e Lartë Gjyqësor,
- (ii) Këshillin e Lartë të Prokurorisë,
- (iii) Unionin e Gjyqtarëve të Shqipërisë,
- (iv) Shoqatën Kombëtare të Gjyqtarëve të Shqipërisë,
- (v) Shoqatën e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë,
- (vi) Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme,
- (vii) Prokurorin e Përgjithshëm,
- (viii) Kryetarin e Gjykatës së Lartë.

2. Në mbështetje të nenit 32 të Rregullores së Kuvendit, thirrjen e mbledhjes së Komisionit, ditën e marte, datë 15 Shtator 2026, ora 14:00, me rend dite *"Seancë dëgjimore publike me institucionet e drejtësisë dhe shoqatat e magistratëve lidhur me projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar"*.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

DEPUTETËT

1. Gazment Berolli
2. Juale Tebelen
3. Elda Hoti
4. EDI BALOKA

PD kërkon të thirren në seancë dëgjimore për të dhënë mendimin e tyre institucionet dhe shoqatat që kanë interes në këtë çështje, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Unioni i Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata Kombëtare e Gjyqtarëve të Shqipërisë, Shoqata e Prokurorëve të Republikës së Shqipërisë, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, Prokurori i Përgjithshëm, kryetari i Gjykatës së Lartë.

"Kjo nënkupton edhe që gjatëshqyrtimit dhe miratimit të propozimeve ligjore që prekindrejtëpërdrejt garancitë kushtetuese të magistratëve, kupërfshihen pagat e tyre, procesi ligjvënës duhet të përfshijë njëanalizë tërësore dhe të detajuar të qëllimit të synuar dhepasojave të pritshme, sikundër duhet të sigurojë edhepjesëmarrjen aktive të vet gjyqtarëve/magjistratëve osegrupimeve që i përfaqësojnë ata. Ky konsultim duhet të jetë, mbi të gjitha, edhe efektiv", theksohet në kërkesë.

Më 29 korrik, CNA publikoi të dhënat e siguruara nga dokumenti i projektligjit, që në thelb synon "blerjen" e Gjykatës Kushtetuese nga mazhoranca, pasi ndryshimet favorizojnë gjyqtarët dhe magjistratët e këtij institucioni, që kanë në dorë vendimet për zyrtarët e lartë shqiptarë./CNA



SKANDALI/ Mazhoranca propozon blerjen e Gjykatës Kushtetuese



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.